



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Policy Brief 2°

(Dokumente Politikash – Seria III, 2010)

“Zhvillimi Rural si një Qasje Ndër-Sektoriale dhe Implikimet për Shqipërinë”


PËRMBAJTJA

.....
Sfondi

1. Koncepti i Zhvillimit Rural
 - 1.1 Koncepti i Qëndrueshmërisë dhe Zhvillimit Rural të Qëndrueshëm
2. Situata e Zhvillimit Rural në Shqipëri dhe Implikimet për të Ardhmen
 - 2.1 Strategjia e Zhvillimit Rural në Shqipëri kundrejt Tendencave të BE-së
3. Nevoja për një Qasje Ndërsektoriale
 - 3.1 Varfëria Rurale dhe Diferencat Rajonale
 - 3.2 Mirëqënia: *Qëllimi Shumë-Dimensional i Zhvillimit Rural*

Rekomandimet Kryesore

Qershor 2010



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

**Think Tank Fund
OSI Network**

Ky dokument politikash është një produkt i Departamentit të Qeverisjes Vendore dhe Zhvillimit të Integruar i IDN-së i cili realizohet me mbështetjen financiare të Fondit Think Tank, Program i Rrjetit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur (Budapest, Hungari).

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë botim janë të ekspertëve të Departamentit të Qeverisjes Vendore dhe Zhvillimit të Integruar dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

Përgatitur nga:

Departamenti i Qeverisjes Vendore dhe Zhvillim i Integruar (QVZhI)

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Znjsh. Erisa **ÇELA**, Drejtore Departamenti QVZhI

Dr. Etleva **DASHI**, Eksperte e Asociuar

Dr. Fatmir **GURI**, Ekspert i Asociuar

Sfondi

Rural është ai vend ku ndodh përballja, ndërveprimi dhe transformimi reciprok i njeriut me natyrën. Kjo lloj përballjeje ndodh përmes një game të gjerë praktikash të cilat janë të lidhura në hapësirë dhe kohë. Kjo përfshin bujqësinë, pylltarinë, peshkimin, gjuetinë, turizmin rural, sportet rurale si dhe jetesën në fshat. Përgjatë historisë, e sidomos në dekadat e fundit, ka patur një zhvendosje madhore brenda këtij ndërveprimi të njeriut me natyrën. Përbërja e tërësisë së praktikave që përbëjnë ekonominë rurale është transformuar plotësisht. Kështu teksa bujqësia është një aktivitet në rënie (të paktën në terma sasiorë), në shumë vende turizmi rural, strehimi, sportet dhe aktivitetet rurale janë shndërruar në elementë kyç të një ekonomie rurale.

Zhvillimi rural është në thelb ri-gjallërim dhe fuqizim i zonave rurale. Si i tillë ai nuk mund të njëjtësohet veç me rritjen ekonomike të zonave rurale (ndonëse shpesh zhvillimi rural në tërësi mund të shpjerë drejt një zhvillimi të tillë ekonomik). Zhvillimi rural synon të ri-pozicionojë konceptin e rurales brenda një koncepti më të gjerë të shoqërisë, duke e bërë ruralen më tërheqëse, më të arritshme, më të çmuar dhe më të dobishme për shoqërinë. Për shumë dekada, e në shumë vende, përfshi këtu Shqipërinë, zonat rurale janë kuptuar dhe menaxhuar duke u bazuar në konceptin klasik “urban vs. rural”. Ky dokument politikash synon të hapë një diskutim mbi atë çka nënkupton zhvillimi rural, rrjetet dhe shumëllojshmëria e hapësirave rurale. Mbi të gjitha ky dokument synon të paraqesë një qasje që nuk supozon se ruralja dhe urbania janë përjashtuese të njëra-tjetrës. Një ndarje e tillë nuk i përshtatet më karakteristikave hapësinore, kulturore, ekonomike dhe sociale të Europës së shekullit XXI.

Në Shqipëri zhvillimi ekonomik dhe social i zonave rurale ka pasur një historik të trazuar gjatë njëzet viteve të fundit. Kalimi nga strategjia sektoriale në atë rurale, ka qenë një zhvillim i rëndësishëm i fillim viteve '90 në vendin tonë. Ndryshimet demografike, ekonomike, sociale apo kulturore të cilat prekin sot hapësirat rurale na çojnë drejt një dinamike organizative, e cila nënkupton zhvillimin dhe forcimin e të gjithë institucioneve si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të një zone rurale. Këto ndryshime institucionale na japin një dimension të ri të zhvillimit rural duke promovuar një teori shumë të rëndësishme, atë të analizës së mënyrave të qëndrueshme të jetesës. **Për kushtet e realitetit shqiptar, a mund të adoptojmë një teori të zhvillimit rural dhe a mund të shpjegojë kjo teori mënyrat e funksionimit të shoqërive rurale?**

Shqipëria është një vend relativisht i vogël, me relief të theksuar malor dhe me një popullsi prej 3,142,239 banorësh¹. Vetëm 24 përqind e tokës së saj klasifikohet si tokë bujqësore, 36 përqind janë pyje dhe 15 përqind kullota². Ende, bujqësia përbën bazën e të ardhurave për pjesën më të madhe të popullsisë dhe shërben si një burim punësimi. Shqipëria rurale është shumë më tepër e varur në bujqësi se shumica e shteteve Evropiane dhe ka zhvilluar shumë pak prodhimin dhe shërbimet përkatëse. Forca kryesore e punës në vend është e lidhur me bujqësinë ndërkohë që të gjithë të dhënat e zhvillimit ekonomik dhe njerëzor janë më të ulëtat në rang kombëtar krahasuar me sektorët e tjerë të ekonomisë. Përafërsisht, gjysma e GDP-së së Shqipërisë prodhohet nga sektori i shërbimeve. Bujqësia vazhdon të ulet, por përfaqëson ende 16.3% të GDP-së dhe mbetet punëdhënësi më i madh me 58% të popullsisë së punësuar.³

Në rastin shqiptar, teoria e zhvillimit të qëndrueshëm duhet të jetë në gjendje t'i japë përgjigje një sërë problemesh të perceptuara nga ne e që lidhen me zhvillimin e zonës rurale të tilla si:

- Problemet e funksionimit të një shoqërie rurale (që nga mënyrat e organizimit të jetesës e deri te format e zhvillimit të aktiviteteve ekonomike e sociale)
- Raportet që ekzistojnë midis bujqësisë dhe sektorëve të tjerë nga ku i zhvillon këta të fundit por edhe varet zhvillimi bujqësor i zonës
- Problemet që lidhen me mënyrat e adaptimit të shoqërisë rurale me mjedisin lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar
- Problemet që ndesh shoqëria rurale në raport me strukturat shtetërore si dhe raportet që janë ndërtuar midis tyre.

Ky dokument do t'i shërbejë përpjekjeve në vazhdim për të intensifikuar zhvillimin në zonat rurale përmes një qasjeje shumë-dimensionale. Ai siguron një trajtim të gjithanshëm të situatës aktuale në zonat rurale në Shqipëri, merr në shqyrtim mundësitë ekzistuese, sugjeron veprime për përballimin e problemeve, identifikon prioritete aty ku është e mundur dhe rekomandon fushat e angazhimit për të ardhmen.

¹ " Shqipëria ne Shifra 2007" INSTAT 2008

² Idem

³ Raport Progresi i KE për Shqipërinë 2009: "Sectoral and enterprise structure" fq. 24.

1. Koncepti i Zhvillimit Rural

Zhvillimi rural është përkufizuar si një proces shumë i ndryshueshëm, duke pasur si objektiv kryesor në të gjithë botën, mirëqenien e banorëve të zonave rurale. Mënyra e funksionimit dhe forma e tij përcaktohet dhe influencohet nga shumë faktorë të zonave rurale të një vendi. Kjo fushë i referohet së pari termit zhvillim, që nënkupton një ndryshim pozitiv, ose më tepër një progres në një popullsi të caktuar. Që ky zhvillim të jetë rural atëherë ai duhet të zbatohet në një zonë rurale. Në këtë mënyrë duam thjesht të tregojmë se nuk bëhet fjalë vetëm për zhvillimin bujqësor, por njëkohësisht marrim në konsideratë edhe aktivitetet e tjera ekonomike.

Pra, zhvillimi rural është një sistem i ndërlikuar në të cilin bëjnë pjesë ndryshimet ekonomike, sociale dhe politike, duke bërë të mundur në këtë mënyrë ndryshimin e vetë shoqërisë nga një shoqëri tradicionale në një shoqëri moderne. Ky modernizim përfshin shumë faktorë si : ndarjen e punës, urbanizimin, industrializimin, zhvillimin e pushtetit lokal etj.

Sipas kësaj teorie përcaktimi i zonave urbane dhe rurale has shumë vështirësi në realitet sepse në zona të ndryshme kemi densitete e përqendrime të ndryshme të popullsisë dhe karakteristikat e identifikimit të zonave duhet të jenë më të qarta. Gjithashtu vende të ndryshme mund të përdorin kritere të ndryshme në përcaktimin e tyre.

1.1 Koncepti i Qëndrueshmërisë dhe Zhvillimit Rural të Qëndrueshëm

Kur flasim për konceptin e zhvillimit rural koncepti i zhvillimit është shumë më kompleks sepse në të përfshihet dhe koncepti i qëndrueshmërisë. Në raportin “Kujdesja për Tokën” të pregatitur në 1992 nga Unioni Ndërkombtar për Ruajtjen, Fondi Mbarë Botëror për Natyrën dhe Programi i Ambjentit të Kombeve të Bashkuara pohohet:

“Të jetuarit në mënyrë të qëndrueshme varet nga të pranuarit e detyrës për të kërkuar harmoni me njerëzit e tjerë dhe me natyrën. Rregullat janë që njerëzit duhet të ndajnë mes tyre dhe të kujdesen për Tokën. Njëërzimi duhet të mos marrë nga natyra më shumë se ajo mund të zëvendësojë. Kjo si rrjedhojë kupton adaptimin e mënyrave të jetës dhe rrugëve të zhvillimit që respektojnë dhe operojnë brenda limiteve që lejon natyra”

Vlera e konceptit të qëndrueshmërisë është parë në aftësinë për të kapërcyer ndarjet midis interesave të ambientalistëve, ekonomisë dhe politikës. Që nga kjo rrjedh edhe përkufizimi i bujqësisë së qëndrueshme të dhënë nga FAO, i cili është pritur dhe aprovuar shumë në planin ndërkombëtar.

« Koncepti i një bujqësie të qëndrueshme kërkon të favorizojë zhvillimin e qëndrueshëm në bujqësi, në peshkim, dhe në sektorin e silvikulturës, për të ruajtur tokën, ujin, bimët dhe burimet gjenetike të kafshëve, të mos degradojë këto të fundit, të përdorë teknika të përshtatshme, ekonomike të frytshme dhe të pranueshme nga ana sociale ».

Ka shumë studjues të teorisë së zhvillimit, të cilët mbrojnë idenë e një shoqërie të qëndrueshme, që kritikojnë shumë recetat e ekonomisë tradicionale dhe besojnë që: *“ekonomia e tregut në vetvete nuk mbështet një shoqëri të qëndrueshme”⁴*

2. Situata e Zhvillimit Rural në Shqipëri dhe Implikimet për të Ardhmen

Koncepti i zhvillimit rural në Shqipëri është relativisht i vonë dhe i ka zëvendësuar pak nga pak konceptin e strategjive sektoriale të ndërmarra në Shqipëri në zonat rurale të vendit përgjatë të gjithë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Megjithë pranimin në nivel politik të këtij koncepti që në fillim të viteve '90, realisht politikat publike gjatë kësaj periudhe kanë qenë të amullta dhe nuk kanë tejkaluar hartimin e strategjive pak të zbatuar në praktikë.

Përafrimi i integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), kërkoj jo vetëm një përpjekje më thelbësore në ndërtimin e një strategjie të zbatueshme për zhvillimin e zonave rurale, por edhe përputhshmërinë e kësaj të fundit me linjat strategjike të Komunitetit për zhvillimin rural. Në këtë kuadër është ndërtuar edhe Strategjia e zhvillimit rural 2007-2013.

Strategjia bazohet në katër akse prioritare që kanë të bëjnë me:

- përmirësimin e konkureshmërisë së bujqësisë, agro përpunimit dhe sektorit të pyjeve;
- ruajtjen e peizazheve kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit;

⁴Brown and Shaw, 1982.


- përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe nxitja e diversifikimit ekonomik;
- zhvillimi rural me bashkëpunim.

Fakti se strategjia është bazuar në udhërrëfyesin strategjik të Komunitetit, është **një avantazh i rëndësishëm** sepse siguron:

- Përputhshmërinë e objektivave të Strategjisë së Zhvillimit Rural (SZHR) me objektivat e IPARD;
- Koherencën e masave kombëtare dhe atyre të IPARD;
- **Koordinimin e politikave të ministrive të ndryshme të linjës për problemet e zhvillimit rural. Ky është një dokument bashkërendues, fakt që duket jo vetëm në titullin e tij por edhe në parashikimin për ndërtimin e një Grupi Pune Ndërministror (GPN).**

Përveç këtyre, ky është një dokument i ndërtuar për të planifikuar ndërhyrjen e donatorëve të ndryshëm që duan të veprojnë në fushën e zhvillimit rural, në kontekstin e anëtarësimit të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë në BE. Duket se ky aks përbën edhe pjesën më të rëndësishme të financimeve publike të parashikuara në këtë strategji (60% të totalit), duke rrezikuar kështu që strategjia e zhvillimit rural të bjerë në grackën e një politike sektoriale. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur struktura e fondeve të parashikuara për vitin 2013

Grafik 1 : Shpërndarja e parashikuar e fondeve të SZHR për vitin 2013



Burimi: MBUMK

Aksi I Në aksin e parë është masa e mbështetjes së fermave bujqësore ajo që ka përpjesën më të rëndësishme të fondeve të parashikuara.. Në këtë kuadër shihet se SZHR, kryesisht mbështet prodhimin bujqësor dhe infrastrukturën. Kjo masë megjithëse i drejtohet në mënyrë direkte përmirësimit të nivelit të prodhimit bujqësor përsëri lë pa trajtuar në mënyrë tërësore problemin e konsolidimit të fermave të cilat në nivelet aktuale janë shumë larg sigurimit të ekonomive të shkallës. Megjithëse e domosdoshme, përsëri nuk parashikohet deri në vitin 2013 një reformë grupimi të tokave të fermës, por tentohet në mënyra të tërthorta të arrihet ky objektivi (nëpërmjet daljes në pension të parakohshëm të fermerëve dhe instalimit të fermerëve të rinj apo bashkimit të fermerëve në kooperative) masat të cilat duket se do të kenë rezultate të dyshueshme⁵. Nga ana tjetër përmirësimi i cilësisë së produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara duket se është një prej masave më të drejta që merren në kuadër modernizimit të bujqësisë dhe agro-industrisë. Mjafton të theksojmë se FYROM e cila është shumë më përpara në procesin e integritimit se sa Shqipëria, i kushton masës së konsolidimit të tregjeve rreth 75% të mbështetjes totale të fondeve IPARD që merr nga BE.

Aksi i II i ruajtjes së peizazhit kulturor dhe i mjedisit megjithëse një prej elementëve kryesorë në politikat e zhvillimit të zonave rurale në BE, në strategjinë Shqiptare, mbetet i pa organizuar qartë dhe i diskutuar vetëm në nivel të përgjithshëm pa specifikuar elementët përbërës si edhe masat që duhet të ndërmerren.

Aksi III Përmirësimi i jetës në zonat rurale, e cila është e kufizuar në dy masa të vetme i) diversifikimi i sektorëve ekonomikë në zonat rurale dhe ii) infrastruktura e zonave rurale. Të dy këto masa janë mëse imediate për sa i përket zonave rurale në Shqipëri, por përpjesa e këtij aksi është shumë e ulët në krahasim me nivelin total të fondeve të miratuara kur struktura e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale shqiptare e bën diversifikimin e aktiviteteve elementin thelbësor të zhvillimit afatgjatë.

Aksi IV Pjesëmarrja në zhvillimin rural është aksi i cili parashikon organizimin e grupimeve lokale në zonat rurale, thithëse dhe përçuese të fondeve kombëtare por edhe atyre të cilat do të vijnë nga institucionet ndërkombëtare. Zhvillimi në mënyrë të qëndrueshme të këtij aksi, është elementi thelbësor që mundëson integrimin e zonave rurale shqiptare në fondet e ndihmës indirekte të BE. Eksperienca e Grupeve të Bashkëveprimit Lokal (GBL) mbartëse të projekteve LEADER 1,

⁵ Reforma e pensioneve të pleqërisë në zonën rurale kërkon një analizë shumë më të thellë dhe nga ana tjetër mund të mos çojë në rezultatet e pritura për vetë faktin e ekzistencës së një papunësie të fshehur në zonat rurale dhe mundësisë së ndarjes së tokës midis pasardhëve të familjes që do të çonte në një copëzim akoma më të skajshëm të fermës.

LEADER 2, LEADER +, do të mundësojë krijimin në zonat rurale të asaj strukture organizimi shoqëror që do të mbartë projektet e ardhshme në zonat rurale.

2.1 Strategjia e Zhvillimit Rural në Shqipëri kundrejt Tendencave të BE-së

Strategjia e zhvillimit rural në Shqipëri (SZHR) aktualisht gjendet përballë ndryshimit strategjik që po pëson Strategjia e Zhvillimit Rural në Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB). Si financuesja kryesore në afatin e gjatë të politikave kombëtare të zhvillimit rural në vend, SZHR duhet të jetë plotësisht në përputhje me akset kryesore të PPB.

Aktualisht PPB gjendet në një debat të rëndësishëm midis tre grupeve të ravijëzuara si: i) grupi liberal, ii) grupi “konservator” që mbështet aksin e parë dhe jo aksin e dytë, iii) grupi i rikombëtarizimit i fondeve të PPB.

- i) Grupi liberal përfaqësohet nga Evropa Veriore (vendet e Benelux) që kërkojnë një ulje të ndërhyrjes së PPB në tregjet e produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara, duke u mbështetur në parimin se produktet bujqësore nuk kanë status të veçantë që të ketë një mbështetje të veçantë.
- ii) Grupi konservator i cili përfaqësohet nga Franca, Italia, Anglia, Spanja (Prodhuesit kryesorë bujqësorë në kuadër të vendeve të BE-së) të cilët kërkojnë zgjatjen sa më shumë që të jetë e mundur të mbështetjes së aksit të parë pra mbështetje direkte të produkteve.
- iii) Grupi i rikombëtarizimit të fondeve i cili përfaqësohet kryesisht nga Gjermania (një prej kontribuesve kryesorë e PBB), i cili kërkon shpërndarjen e fondeve sipas kontributeve kombëtare, duke favorizuar kështu kontribuesit e mëdhenj ndaj prodhuesve të mëdhenj⁶.

Autoriteti i politikë-berjes në Shqipëri ka mbështetur strategjinë e saj duke patur parasysh aksin e parë të PPB por pikërisht ky aks është aktualisht pjesë e një debati të gjerë për sa i përket efektivitetit të ndërhyrjes (vartësi e thellë e fermerëve nga fondet e mbështetjes, mbi prodhim bujqësor, kosto të rëndësishme për buxhetin e PPB, etj.) ndaj edhe kërkon procese të thella rinovimi të cilat priten të ulin akoma më shumë fondet e parashikuara për këtë aks. Në këtë kontekst

⁶ Ky grup i shfaq për herë të parë në mesin e viteve '80 i kryesuar nga Anglia e Theçerit (Thatcher), me moton e e famshme *I want my money back* (Unë dua përsëri paratë e mia).

Programi i Zhvillimit Rural në Shqipëri duhet që të ketë në konsideratë problemet e zonave rurale shqiptare nën një politikë të përgjithshme mbështetje e cila është në ndryshim të vazhdueshëm dhe që mundet të ndëshkojë nivelin kombëtar të përthithjes së fondeve. Prandaj është shumë i rëndësishëm një proces programimi inovator i cili mbështetet në kontekstin e bujqësisë shqiptare (studimet sektoriale) dhe gjithashtu në përputhje me trajektoren evropiane të zhvillimit të bujqësisë së përbashkët. Që më vonë të mos përsëritim refrenin “E humbëm edhe këtë tren”.

3. Nevoja për një Qasje Ndërsektoriale

Është e dukshme që Objektivi i Zhvillimit të Mijëvjeçarit për reduktimin e varfërisë nuk mund të arrihet pa i kushtuar vëmendjen e duhur varfërisë rurale. Zonat rurale në Shqipëri janë shumë më prapa në zhvillim sesa zonat urbane dhe po aq prapa në plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, e sidomos ato lidhur me arsimin, shëndetin, çështjet mjedisore, statusin e grave rurale, etj. Pavarësisht nga të gjitha zhvillimet pozitive, varfëria është ende e qëndrueshme dhe godet më ashpër zonat rurale. Pabarazia në nivelin e të ardhurave është e lartë referuar standardeve rajonale dhe varferia është më e lartë në familjet me një nivel të ulët shkollimi dhe me shumë fëmijë. Shumë familje në zonat rurale nuk kanë akses në infrastrukturën bazë, përfshirë edukimin bazë dhe shërbimet shëndetësore.⁷

Ndërkohë strategjitë për hapësirën rurale duhet të shkojnë përtej përmirësimit të rendimentit bujqësor. Ndërsa bujqësia vazhdon të luajë një rol kryesor në zonat rurale shqiptare në drejtim të sigurimit të të ardhurave dhe mundësive për punësim, shumë faktorë të tjerë ndërlidhës duhet të merren në konsideratë në mënyrë që të realizohen ndryshime strukturore, të përmirësohet infrastruktura sociale dhe të rriten të ardhurat. Ndërsa diskutimet e këtij dokumenti shkojnë përtej çështjeve bujqësore, në mënyrë që të arrihet një panoramë sa më e plotë e sektorit rural, ende ka çështje që mbeten të patrajuara. Këto çështje janë arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale në zonën rurale. Perjashtimi tyre nuk nënkupton se ato janë më pak të rëndësishme për zhvillimin rural.

⁷ “Strategjia e Zhvillimit Rural për Shqipërinë : Mbeshtetje për rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm” Departamenti i Zhvillimeve të Qëndrueshme Sociale dhe Mjedisore për Evropën dhe Azinë Qendrore, Banka Botërore, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Shqipëri.

3.1 Varfëria Rurale dhe Diferencat Rajonale

Varfëria në zonat rurale në Shqipëri ka shumë dimensione si: (a) niveli i ulët apo shumë i ulët i të ardhurave; (b) rreziku i lartë nga sëmundjet dhe mungesa e shërbimeve të përshtatshme shëndetësore; (c) niveli i ulët i shkollimit; dhe (d) aksesit i kufizuar në institucionet vendim-marrëse qeverisëse;

Në rastin e Shqipërisë varfëria ka edhe një dimension rajonal. Qarqet Kukësit dhe Dibrës, në rajonin malor verior dhe Elbasani në rajonin qendror, mund të konsiderohen si më të varfërat. Familjet në Tiranë, Durrës dhe Vlorë, në ultësirën bregdetare, janë mesatarisht në një nivel më të mirë. Niveli shumë i ulët i shpërndarjes së tokës së punueshme për frymë në zonat rurale, konsiderohet si një nga shkaqet kryesore të varfërisë në zonat rurale. Duke mos patur mjete të tjera jetese, përveç tokës bujqësore, pjesa më e madhe e familjeve në rrethet e Dibrës, Kukësit, Tropojës, Shkodrës, Mirditës dhe Matit mbështeten kryesisht në të ardhurat dhe produktet e fermës së tyre.

Diferencat rajonale në lidhje me burimet, pozicionin gjeografik, infrastrukturën, klimën, etj., duhet të merren në konsideratë kur merren vendime strategjike për buxhetin, përmirësimet në infrastrukturë dhe zhvillimin e shërbimeve nëpër zonat rurale. Qarqet e Shqipërisë ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në drejtim të klimës, terrenit dhe aksesit në shërbimet dhe tregjet rurale, si dhe zhvillimin e infrastrukturës. Këto diferenca rajonale, veçanërisht për zonat më të largëta si ato verilindore, japin ndikimin e tyre në çfarëdolloj rrugë zhvillimi që vendi mund të zgjedhë. Këto diferenca duhet gjithashtu të ndikojnë edhe në vendimet mbi rrugët sesi mund të ndihmohen nëpërmjet programeve të ndryshme zona specifike. Nuk ekziston asnjë metodologji që do t'i përshtatej njëloj të gjitha rajoneve.

Ekziston një konsensus i gjerë mbi faktin se zhvillimi ekonomik përbën një faktor kryesor për uljen e varfërisë. Megjithatë, dihet gjithashtu se rritja mesatare ekonomike ka pasur një ndikim modest tek varfëria rurale, përveçse me anë të migrimit në zonat qytetare. Kjo ndodh sepse rritja shpesh nuk krijon mundësi të reja në rajonet rurale ku janë të vendosur të varfrit. Pajisja me asete e të varfërve nuk ndikon mbi varfërinë rurale nëse këto nuk vendosen në kontekstin ku rritja ekonomike u ofron atyre mundësi punësimi dhe investimi. Ky është qëllimi i zhvillimit rajonal.

3.2 Mirëqënia: *Qëllimi Shumë-Dimensional i Zhvillimit Rural*

Një dimension shumë i rëndësishëm i mirëqënies është niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat e pamjaftueshme nënkuptojnë varfëri. Të ardhurat e pasigurta

nënkuptojnë cënueshmëri (*vulnerabilitet*), çka mbart pasoja të pakthyeshme, si psh shitja e aseteve prodhuese, largimi i fëmijëve nga shkolla si reagim ndaj të ardhurave të pakta e jo të vazhdueshme, keq-ushqyerje çka ndikon në zhvillimin fizik dhe mendor, etj. Gjithashtu, të ardhurat e papërshtatshme minojnë pjesëmarrjen dhe vullnetin e komuniteteve rurale për të kontribuar në sipërmarrje sociale. Ndërkohë ka edhe dimensione të tjera që janë plotësuese të të ardhurave por nga natyra janë pjesë e të mirave publike. Kjo përfshin zhvillimin social të individit në një zonë të caktuar rurale (shëndeti, arsimi, ushqimi), qëndrueshmëria në shfrytëzimin e burimeve natyrore, si dhe gëzimi i një statusi social. Avancimi i një mirë-qënieje të tillë shumë dimensionale është kusht për një zhvillim rural të suksesshëm.

Nga ana tjetër vlera e gjenerimit të të ardhurave të aseteve varet nga cilësia e kontekstit ku ato përdoren. Përdorimi i mirë i aseteve në një kontekst jo të favorshëm nuk do të ndihmojë familjet rurale që të zhvillohen. Aksesit tek toka për shembull është i efektshëm për të nxjerrë familjet nga varfëria vetëm nëse arrihet konkurrueshmëria e tyre, çka varet thellësisht nga struktura e tregjeve, institucioneve, mallrave publike dhe politikave në ambientin ku ato veprojnë. Aspekte të rëndësishme të kontekstit që përcaktojnë përdorimin optimal të aseteve përfshijnë:

- Mallra të tregtueshme bujqësore;
- Mjedis kombëtar i përshtatshëm i politikës në nivel makro (rritja, kursi i këmbimit) dhe në atë sektorial (politikat e tregtisë, subvencionet);
- Natyra dhe cilësia e qeverisjes në nivel kombëtar dhe lokal;
- Të mirat publike, si psh puna kërkimore mbi bujqësinë, shërbimet e ekstensionit si edhe infrastruktura;
- Performanca e tregjeve, sidomos në lidhje me konkurrueshmërinë, kostot e transfertave dhe limitimet e aksesit nga të varfrit;
- Institucionet rurale si psh shërbimet financiare dhe organizatat e komunitetit për shërbime dhe siguri të ndërsjellë;

Pra, ky shumë-dimensionalitet i kontekstit sërisht sugjeron një sërë pikash hyrëse dhe plotësuese për programet e zhvillimit rural që synojnë ngritjen e prodhimit të aseteve që përdoren prej komuniteteve rurale.

4. Rekomandimet Kryesore

Të gjeturit e një rruge për një zhvillim rural të sukseshëm mund të arrihet nëpërmjet ecjes në një sërë rrugësh alternative. Deri më sot ka qenë në një masë të gjerë migrimi i banorëve të zonave rurale drejt mjediseve urbane. Por nëse këta imigrantë nuk janë të përgatitur për të konkurruar në tregun e punës urban (ku arsimimi është kryesor) kjo vetëm mund të çojë në zhvendosjen e varfërisë nga zonat rurale në ato urbane. Ndaj është shumë e rëndësishme të krijohen mundësi zhvillimi e jetese në zonat rurale, e jo vetëm përmes bujqësisë.

Zhvillimi i integruar rural ofron një mundësi të konsiderueshme për uljen e masës së varfërisë në zonat rurale. Sërisht kjo nuk mund të ndodhë e vetme. Kjo përbën një ndërmarrje komplekse shumë dimensionale e ndërsektoriale, e cila është gjerësisht e pa-eksploruar sa duhet dhe ku ka ende shumë për t'u mësuar. Në vazhdim, heterogjeniteti i lartë i kushteve nën të cilat komunitetet e zonave rurale veprojnë kërkon kreativitet dhe fleksibilitet në hartimin dhe implementimin e projekteve dhe kjo duhet bërë në nivel lokal nëpërmjet decentralizimit dhe pjesëmarrjes së vetë komuniteteve rurale.

Bujqësia ofron një tjetër mënyrë. Këtu nuk është e rëndësishme puna në fermë sipas metodave tradicionale dhe mbledhja në parcela të vogla toke që nuk do të gjenerojnë ndonjëherë mjaftueshëm të ardhura për zhdukjen e varfërisë por mundësitë e ofruara ndaj fermerëve të vegjël prej bujqësisë së re. Kjo konsiston në prodhimin e të mbjellave që gjenerojnë vlerë të shtuar të lartë, në kërkimin e tregjeve që sjellin fitim, në ndërmarrjen e kontrolleve të cilësisë dhe ushqimeve, çertifikimi dhe etiketimi produkteve, kërkimi kontratave me super-marketet, agro industria dhe agro përpunimi etj.

Një mënyrë e rëndësishme për të aplikuar zhvillimin e integruar rural është nëpërmjet aktiviteteve jo bujqësore duke përfshirë punësimin në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, vetëpunësimi në ndërmarrjet e vogla (p.sh. industritë kulturore). Kombinimi i bujqësisë (sidomos i prodhimit të të mbjellave të pakta në parcela të vogla toke për konsum familjar) dhe i aktiviteteve jo-bujqësore çon në shtrirjen e pluri-aktiviteteve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rajonet më të pazhvilluara ku bujqësia e re ka potencial të ulët zhvillimi.

Gjithashtu nuk duhet të harrohet se zhvillimi rural nuk nënkupton vetëm rritje ekonomike. Në vetvete përfshin dhe dimensionin social e kulturor që janë po aq të domosdoshëm për zhvillimin e potencialit të plotë të një individi që jeton në zonat rurale. Lidhur me këtë, disa rekomandime konkrete të lidhura me zonat rurale do të ishin:

- ✓ Nxitja e përfshirjes sociale të komuniteteve rurale për pjesëmarrjen në politikëbërje si aktorë në nivel kombëtar/rajonalë/lokalë gjatë procesit të politikëbërjes

Kjo përfshin:

- Nxitjen e organizatave lokale dhe pjesëmarrjen e grupeve rurale nëpër këto organizata. (LAG-et do të ishin një nga opsionet)
- Ofrimi i mbështetjes teknike dhe financiare për organizatat lokale nëpërmjet granteve konkurruese;
- Nxitja e forcimit të organizatave kryesore dhe koalicioneve pro komuniteteve rurale për përfaqësimin e tyre politik.

- ✓ Nxitja e zhvillimit rajonal dhe përfshirjes ekonomike të komuniteteve rurale

Kjo përfshin:

- Përcaktimin e rajoneve dhe koalicioneve të komunave e bashkive mikse për të ndërmarrë projekte lokale me përfitim ekonomik.
- Vendorsja e institucioneve për koordinimin, planifikimin dhe reklamimin e traditës së rajoneve.

Kjo shumëllojshmëri rrugësh për të zhvilluar zonat rurale gjithashtu nënkupton se ndërhyrjet e zhvillimit rural për të ofruar mundësi rritjeje janë të ndryshme dhe të shumta. Kjo është arsyeja përse nevojitet një qasje territoriale shumë-sektoriale për zhvillimin rural që shkon përtej përqendrimit sektorial.

